

VENDIM
Nr.612, datë 21.9.2004

**PËR SHNDËRRIMIN E SHKOLLËS SË LARTË TË INFERMIERISË NË TIRANË, NË
FAKULTET TË INFERMIERISË, NË VARËSI TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shndërrimin e shkollës së lartë të infermierisë në Tiranë, në Fakultet të Infermierisë, në varësi të Universitetit të Tiranës, me kohëzgjatje studimi 3-vjeçar.
 2. Ndërtesa, pajisjet dhe personeli ekzistues i kësaj shkolle t’i kalojnë këtij fakulteti.
 3. Vendimi nr.494, datë 5.8.1996 i Këshillit të Ministrave “Për shkollën e lartë të infermierisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.
 4. Ngarkohet Ministri i Arsimit dhe i Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Fatos Nano